



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.98**

**25 korrik**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.112, datë 21.7.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit..... 3971
Vendim i Kuvendit nr.113, datë 21.7.2011	Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit..... 3971
Vendim i Kuvendit nr.114, datë 21.7.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 3971
Vendim i Kuvendit nr.115, datë 21.7.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 3972
Vendim i Kuvendit nr.116, datë 21.7.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 3972
Vendim i Kuvendit nr.118, datë 21.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.82, datë 23.1.2011 “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011”..... 3973
Vendim i Kuvendit nr.119, datë 21.7.2011	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve..... 3973
Vendim i Kuvendit nr.120, datë 21.7.2011	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.. 3973

Vendim i Kuvendit nr.121, datë 21.7.2011	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Drejtësisë.....	3974
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7. 2011	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2010.....	3974
Udhëzim i KM nr.1, datë 16.6.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.....	3975

**VENDIM**  
**Nr.112, datë 21.7.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Alban Karapici zgjidhet anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.113, datë 21.7.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zonja Endira Bushati zgjidhet Kryetare e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.114, datë 21.7.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zonja Lindita Lati zgjidhet anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.115, datë 21.7.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Servete Gruda zgjidhet anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.116, datë 21.7.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 19 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deputetët Rajmonda Bulku dhe Ilir Bano caktohen anëtarë në vend të deputetëve Eduard Halimi dhe Aldo Bumçi, deputeti Viktor Gumi caktohet sekretar.

II. Në Komisionin për Integrimin Europian deputetja Mesila Doda caktohet nënkryetare, deputeti Gerti Bogdani caktohet sekretar, deputeti Viktor Gumi caktohet anëtar. Deputeti Aldo Bumçi largohet nga ky komision.

III. Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare deputeti Gjok Uldedaj caktohet anëtar në vend të deputetit Ilir Bano.

- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.118, datë 21.7.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.82, DATË 23.1.2011 “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR ZBULIMIN, IDENTIFIKIMIN, PËRBALLIMIN, NEUTRALIZIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E VEPRIMIT TË ORGANIZUAR KRIMINAL PËR DHUNIMIN E INSTITUCIONEVE DHE PËRMBYSJEN E RENDIT KUSHTETUES NË DATËN 21 JANAR 2011”**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Eduard Halimi zëvendësohet me zotin Fatbardh Kadilli.
- II. Zoti Gent Strazimiri zgjidhet kryetar i këtij komisioni.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.119, datë 21.7.2011**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7049, datë 21.7.2011 të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7049, datë 21.7.2011, për shkarkimin e zotit Ferdinand Xhaferaj nga detyra e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.120, datë 21.7.2011**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7050, datë 21.7.2011 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7050, datë 21.7.2011, për emërimin e zotit Aldo Bumçi në detyrën e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM  
Nr.121, datë 21.7.2011

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E  
MINISTRIT TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7051, datë 21.7.2011 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7051, datë 21.7.2011, për emërimin e zotit Eduard Halimi në detyrën e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE PËR VITIN 2010**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave si një nga sfidat kryesore dhe përparësitë e kësaj mazhorance;

- Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në zbulimin, evidentimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave dhe praktikave të pasurimit korruptiv;

- Duke vlerësuar punën sfiduese disavjeçare të këtij institucioni dhe pritshmëritë e tij në përmbushje të çdo detyrimi ligjor;

- Duke qenë i gatshëm kurdoherë në ofrimin e mbështetjes dhe kontributit ndaj propozimeve ligjore, që synojnë forcimin e sanksioneve administrative e penale dhe përmirësimin në tërësi të legjislacionit, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, informalitetit dhe krimit ekonomik;

Konstaton 2010 se ILDKP-ja për vitin 2010:

- Është përpjekur për të forcuar sistemet që nxisin transparencën dhe që parandalojnë konfliktet e interesave dhe aferat korruptive;

- Ka dëshmuar integritet dhe performancë institucionale në rritje, duke treguar vendosmëri dhe paanësi në ushtrimin e kompetencave ligjore për dhënien e masave administrative dhe dërgimin e çështjeve në organin e akuzës, në zbatim të ligjit, për zyrtarët që kanë refuzuar deklarimin e interesave private, kanë fshehur pasurinë apo kanë bërë deklarim të rremë, si dhe për shkelje të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesave;

- Ka promovuar veprimtarinë e vet ndërgjegjësuese nëpërmjet nxjerrjes së metodikave dhe manualeve të ushtrimit të kontrollit e funksionit të drejtëpërdrejtë parandalues;

- Ka forcuar bashkëpunimin e brendshëm ndërinstitucional me struktura të specializuara e përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit e krimit ekonomik;

- Ka shënuar një hap mjaft të rëndësishëm në planin ndërkombëtar, duke u bërë lider në drejtimin e Rrjetit të Agjencive Rajonale kundër Korrupsionit, organizëm i krijuar me institucione homologe të 12 vendeve të Europës Juglindore;

- Ka vazhduar trajnimin me subjektet e parashikuara në ligj, si dhe ka zhvilluar veprimtari të hapura, me synim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me median dhe shoqërinë civile e publikun e gjerë, në lidhje me informacionet dhe denoncimet për shkelje të ligjit të konfliktit të interesave dhe deklarimit të pasurive.

Kërkon nga ILDKP-ja për vitin 2011:

- Të forcojë instrumentet e investigimit administrativ, sidomos në sektorë të jetës publike, ku fenomeni i korrupsionit është më i përhapur dhe besimi i publikut më i ulët;

- Të rrisë ndjeshëm performancën në drejtim të hetimit eficient për të gjithë zyrtarët e lartë publikë;

- Të ndjekë me vendosmëri të gjitha rastet e kallëzimeve penale, të ndërmarra nga ILDKP-ja, në të gjitha shkallët e hetimit gjyqësor;

- Të zgjerojë dhe të nxisë më tej klimën bashkëpunuese me organizatat, institucionet financiare, publike e jopublike, median, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, ALUIZNI-n, ZRPP-në etj.;

- Të jetë më proaktive dhe të iniciojë takime dhe analiza me drejtues dhe prokurorë të njësive të përbashkëta hetimore, me qëllim evidentimin e problemeve dhe ofrimin e zgjidhjeve, në intensifikim të veprimeve, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimeve të çështjeve konkrete, marrjes në konsideratë të veprimeve verifikuese të ILDKP-së nga organi i akuzës;

- Të zbatojë programe inspektimi pranë autoriteteve përgjegjëse, me synimin e rritjes së ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë kundrejt detyrimeve ligjore të autoriteteve përgjegjëse;

- Të rrisë kapacitetin investigues, në bashkëpunim me strukturat homologe të huaja, për zbulimin e rasteve të fshehjeve të pasurisë jashtë vendit;

- Të përmirësojë më shumë bashkëpunimin ndërinstitucional nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave, që institucionet posedojnë, në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë e të gjithanshëm;

- Të eksplorojë praktikatat e vendeve të tjera, për të vënë në praktikën dhe legjislacionin e saj metodika të tjera efikase.

21 korrik 2011

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

## UDHËZIM Nr.1, datë 16.6.2011

### PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 12 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave “Për mbykëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime:

1. Në të gjithë udhëzimin, shprehja “...dega e policisë së ndërtimit zëvendësohet me shprehjen “...Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor/Kombëtar...”.

2. Në ndarjen I “Mbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë dhe i dytë, i pikës 2, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

“Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me certifikatë profesionale përkatëse. Mbikëqyrësi i punimeve për objekte që ndërtohen me financim publik, emërohet nga investitori pas përzgjedhjes me prokurim në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Në rastet kur investitori është edhe sipërmarrës, mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë në asnjë rast punonjës i tij.”.

b) Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1. Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”.

Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.

3.2. Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3. Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, vepohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” .”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Sipërmarrësi duhet të njoftojë, me shkrim, përpara fillimit të punimeve, në seksionin e urbanistikës pranë organeve të qeverisjes vendore, Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik në nivel komune/bashkie/qarku, drejtoritë rajonale tatimore dhe INUK-në, sipas rasteve të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse. Në këtë njoftim të shënohet emërtimi i objektit, të dhënat e investitorit, projektuesit, zbatuesit dhe mbikëqyrësit të punimeve.

Seksioni i urbanistikës dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar/Vendor kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij nxjerrin vendim për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt.

Personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit janë:

- investitori;
- sipërmarrësi;
- mbikëqyrësi i punimeve.

Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:

a) lejen e ndërtimit së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi i cili e ka këtë të drejtë;

b) aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);

c) Projektin e zbatimit të firmosur nga projektuesi dhe të konfirmuar nga komuna/bashkia/këshilli i qarkut, sipas juridiksionit.

Projekti i zbatimit përmban:

- projektin e plotë arkitektonik së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë konstruktiv së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë elektrik së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë hidrosanitar së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë ngrohje-ftohje-ventilim së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë të mbrojtjes nga zjarri së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë të sistemimeve të jashtme së bashku me relacionin teknik shpjegues;
- projektin e plotë të lidhjes së objektit me rrjetet inxhinierike së bashku me relacionin teknik shpjegues;

- Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi).

ç) Studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;



- d) Studimin sizmik;
  - dh) Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit;
  - e) Lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore, të miratuar nga organi kompetent;
  - ë) Ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre;
  - f) Certifikatat profesionale (licencat), të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit (shoqërisë sipërmarrëse dhe mbikëqyrësit);
  - g) Njoftimin për fillimin e punimeve (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - gj) Procesverbalin për fillimin e punimeve në objekt (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - h) Aktin e piktimit të objektit (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - i) Aktkontrollin e kuotës  $\pm 0.00$  (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - j) Dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
  - k) Librezën e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e tyre (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - l) Situacionet mujore pjesore dhe progresive, hartuar në përputhje me pikën 3.3 (formati tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - ll) Librin e kantierit;
  - m) Ditarin e objektit (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - n) Pasqyrën e realizimit të punimeve (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - nj) Procesverbalet e punimeve të maskuara (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - o) Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton etj.
  - p) Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit (në përfundim të kësaj faze);
  - q) Deklaratën teknike të sipërmarrësit (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - r) Aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;
  - rr) Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;
  - s) Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - sh) Dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit nr.312, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, i quajtur Plani i Sigurisë dhe Koordinimit (PSK);
  - t) Siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;
  - th) Siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta.
- Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi përgjigjen për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të mbajtur në objekt.
- Dokumentacioni i objektit ruhet me çdo kusht.”.
- ç) Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:
- “5.1. Investitori, drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt, të përcaktuar në pikën 5 të këtij udhëzimi.”.
- d) Pas paragrafit të parë të pikës 14, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
- “Dosja e mbikëqyrjes së punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit. Mbikëqyrësi i punimeve nuk ndërrohet, me përjashtim të rasteve të detyruara.”.
3. Në ndarjen II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, bëhen këto ndryshime:
- a) në pikën 1, shprehja “...ent prokurues...” zëvendësohet me “... autoritet kontraktor... “ dhe, në fund të kësaj pike shtohet shprehja:
- “Në rastin kur kolaudatori është pjesë e stafit të institucionit që shërben si ent prokurues, fitimi i krijuar nga puna e kryer si kolaudator i një objekti ndërtimi tatóhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.
- b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:
- “6. Zhbllokimi i garancisë së kontratës bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve, ndërsa zhbllokimi i garancisë së punimeve bëhet pas kolaudimit dhe pas afatit të përfundimit të garancisë.”.
- c) Fjalja e parë e shkronjës “d” të pikës 15, ndryshohet, si më poshtë vijon:
- “Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi).”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**AKT DOREZIMI**  
**SHESHIT TE NDERTIMIT**

I mbajtur sot me dt. \_\_\_\_\_ mbi dorezimin e sheshit te ndertimit me adrese:  
" \_\_\_\_\_ " ne prezence te:

**Investitorit**

( \_\_\_\_\_ ) perfaqesuar nga \_\_\_\_\_  
Sektori, Nekontraktori, Dega, etj \_\_\_\_\_ perfaqesuar nga \_\_\_\_\_

**Sipermarresi i Punimeve Shoqeria** \_\_\_\_\_ sh.p.k

1. Drejtuesi Ligjor \_\_\_\_\_
2. Drejtuesi Teknik \_\_\_\_\_
3. Drejtuesi i Kantjerit \_\_\_\_\_

**Mbikqyresi i Punimeve** \_\_\_\_\_ sh.p.k

1. Drejtuesi Ligjor \_\_\_\_\_
2. Inxhinieri zbatues \_\_\_\_\_

Nga verifikimi ne vend u konstatua se sheshi eshte i lire dhe shoqeria sipermarrese  
\_\_\_\_\_ sh.p.k merr ne dorezim sheshin e ndertimit per realizimin e  
punimeve sipas kontrates Nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_ te lidhur midis Investitorit dhe  
sipermarresit per objektin \_\_\_\_\_.

**Sheshi kufizohet:**

Nga Jugu \_\_\_\_\_  
Nga Veriu \_\_\_\_\_  
Nga Lindja \_\_\_\_\_  
Nga Perendimi \_\_\_\_\_

Akt dorezimi mbahet ne tre kopje si me poshte vijon:

- Nje kopje per investitorin \_\_\_\_\_
- Nje kopje per mbikqyresin e punimeve shoqeria \_\_\_\_\_ sh.p.k.
- Nje kopje per sipermarresin shoqeria \_\_\_\_\_ sh.p.k.

**MBIKQYRESI I PUNIMEVE**

**SIPERMARRESI I PUNIMEVE**

-----  
**INVESTITORI**  
-----

**PROÇES VERBAL**

**Mbi fillimin e punimeve në objektin**

" \_\_\_\_\_ "

I mbajtur sot më dt. \_\_\_\_\_ mbi fillimin e punimeve në objektin " \_\_\_\_\_ "

**NDODHESHIN PRESENT:**

**1. Mbikqyrësi i punimeve Shoqëria Konsulente** " \_\_\_\_\_ " .sh.p.k, përfaqësuar nga inxhinier zbatimit \_\_\_\_\_.

**2. Sipërmarrësi i Punimeve, Shoqëria** " \_\_\_\_\_ " sh.p.k përfaqësuar nga

Drejtuesi Teknik \_\_\_\_\_

Shoqëria " \_\_\_\_\_ " sh.p.k depozitoi pranë mbikqyrësit të punimeve kopje të kontratës, preventivin, grafikun e punimeve, listën e makinerive dhe të stafit.

Sipërmarrësi " \_\_\_\_\_ " sh.p.k, ka caktuar në objekt:

**Stafin e përbër nga:**

1. Drejtues Teknik \_\_\_\_\_
2. Drejtues Punimesh \_\_\_\_\_
3. Ing. Topograf \_\_\_\_\_
4. Teknik \_\_\_\_\_
5. Punëtorë \_\_\_\_\_

**Makineritë:**

1 _____ copë _____	6 _____ copë _____
2 _____ copë _____	7 _____ copë _____
3 _____ copë _____	8 _____ copë _____
4 _____ copë _____	9 _____ copë _____
5 _____ copë _____	10 _____ copë _____

Data e fillimit te punimeve eshte \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
SIPËRMARRËSI " \_\_\_\_\_ " sh.p.k të hapë Ditarin e Objektit, të hartojë  
Librezën e Masave dhe të mbajë procesverbalet përkatëse me realizimin e procesve të punës.

Fillimi i Punimeve të nisë nga piketimi i objektit. Të përcaktohen dhe të shënohen në terren piketat sipas projektit dhe pasi të kontrollohen dhe të aprovohen nga mbikqyrësi i punimeve dhe inxhinieri gjeodet të hartohet proces verbal i përkatës , ku të jenë të pasqyruara matjet faktike dhe në rast se nuk ka ndryshime nga projekti ,të vazhdohet me punimet e tjera sipas grafikut të punimeve.  
Proces verbal i mbahet në tre kopje si më poshtë vijon :

- Për investitorin \_\_\_\_\_
- Për mbikqyrësin e punimeve, shoqëria “ \_\_\_\_\_ ” sh.p.k
- Për sipërmarrësin, Shoqëria “ \_\_\_\_\_ ”sh.p.k

**MBIKQYRËSI I PUNIMEVE**

Shoqëria “ \_\_\_\_\_ ” sh.p.k.

**SIPËRMARRËSI I PUNIMEVE**

Shoqëria “ \_\_\_\_\_ ” sh.p.k.

**INVESTITORI**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Datë \_\_\_\_\_

**Për:** \_\_\_\_\_ **Dega** \_\_\_\_\_

**Nga:** “ \_\_\_\_\_ ” sh.p.k

**NJOFTIM**

**FILLIM PUNIMESH NË OBJEKTIN**

“ \_\_\_\_\_ ”

Ju njoftojmë se kemi filluar punimet në objektin: \_\_\_\_\_

në bazë të kontratës nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ lidhur me investitorin \_\_\_\_\_.

Të dhënat kryesore të kësaj kontrate janë si më poshtë:

**Objekti:** “ \_\_\_\_\_ ”.

**Vlera e objektit:** \_\_\_\_\_ lek

**Investitori:** \_\_\_\_\_

**Sipërmarrësi i punimeve:** \_\_\_\_\_

**Projektuesi:** \_\_\_\_\_ sh.p.k

**Mbikqyrësi i punimeve:** \_\_\_\_\_ sh.p.k

**Leja e sheshit të ndërtimit:** \_\_\_\_\_

**Leja e ndërtimit:** \_\_\_\_\_

**Data e fillimit të punimeve:** \_\_\_\_\_

**Data e përfundimit të punimeve:** \_\_\_\_\_

Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin përkatës të këtij objekti.


**Sipërmarrësi**

\_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi**

\_\_\_\_\_





**DITARI I OBJEKTIT**

Objekti : \_\_\_\_\_

Sipërmarresi : " \_\_\_\_\_ " sh.p.k.

Mbikqyresi : " \_\_\_\_\_ " sh.p.k.

MOTI				TEMPERATURAT	
me diell	me diell dhe vranësira	i vrenjtur	me shi	minimale	maximale

**PUNOJNE NE OBJEKT**

**I) Personeli Teknik**

- 1) Përgjegjës \_\_\_\_\_
- 2) Inxhinier ndertimi \_\_\_\_\_
- 3) Teknik ndertimi \_\_\_\_\_
- 4) Inxhinier topograf \_\_\_\_\_
- 5) Arkitek \_\_\_\_\_

**II) Specialiste dhe punetore**

1. Specialiste \_\_\_\_\_
2. Punetore \_\_\_\_\_
3. Manovratore \_\_\_\_\_
4. Roje \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_

**MAKINERI DHE PAJISJE**

- |          |          |           |
|----------|----------|-----------|
| 1. _____ | 5. _____ | 9. _____  |
| 2. _____ | 6. _____ | 10. _____ |
| 3. _____ | 7. _____ | 11. _____ |
| 4. _____ | 8. _____ | 12. _____ |

**SOT U KRYEN KETO PROCESHE PUNE**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

**U MBAJTEN KETO DOKUMENTACIONE TEKNIKE**

1. \_\_\_\_\_
  2. \_\_\_\_\_
  3. \_\_\_\_\_
- Per sipërmarresin: Ing. \_\_\_\_\_

**SHENIME TE MBIKQYRESIT**

Per mbikqyresin : " \_\_\_\_\_ " sh.p.k.  
 Ing : \_\_\_\_\_

**SHENIME TE PERFAQESUESIT TE INVESTITORIT**

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_



7. Zgavrat, plasaritjet dhe hekurat e xhveshura u riparuan në përputhje me rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.

8. Nga kontrolli i kuotave, akteve dhe përmasave të strukturës rezultoi se ato janë brënda largimeve të lejuara sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, me përjashtim të \_\_\_\_\_.

Për të sjellë strukturën në kushtet e projektit janë kryer punimet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Në mbështetje të rezultateve të mësipërm, struktura merret në dorëzim dhe autorizohet vazhdimi i punimeve \_\_\_\_\_

Më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**Drejtuesi teknik i punimeve**

\_\_\_\_\_

**Drejtuesi teknik (ing. i objektit)**

\_\_\_\_\_

**Mbikqyresi**

\_\_\_\_\_

## PROÇES VERBAL

NR \_\_\_\_\_

### **PUNIME TË MASKUAR NË STRUKTURAT BETON-ARME** (Punime betoni dhe armature)

**SIPËRMARRËSI:** " \_\_\_\_\_ "

**OBJEKTI:** " \_\_\_\_\_ "

Emërtimi i elementit: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Sot më datë \_\_\_\_\_, u kontrollua gjendja e punimeve të betonit dhe beton armesë dhe rezultoi si më poshtë:

1. Struktura u betonua prej dates \_\_\_\_\_ deri në \_\_\_\_\_ dhe u përdorë beton i klasës \_\_\_\_\_ i përgatitur nga shoqëria prodhuese e betonit \_\_\_\_\_ Ngjeshja u krye me vibrator sipas kërkesave teknike.
2. Gjatë procesit të betonimit u konstatua ecuria e mëposhtme dhe u morën masat (shënuar përbri)
  - 2.1 \_\_\_\_\_.
  - 2.2 \_\_\_\_\_.
  - 2.3 \_\_\_\_\_.
  - 2.4 \_\_\_\_\_.
3. Ndërprerjet e procesit të betonimit u bënë në pozicionet \_\_\_\_\_ dhe rifillimi i këtij procesi u bë sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
4. Trajtimi dhe mbrojtja e betonit në strukturë \_\_\_\_\_.
5. Heqja e kallëpeve dhe skelave mbajtëse të tyre filloi më datën \_\_\_\_\_ dhe përfundoi më datën \_\_\_\_\_.
6. Gjatë kontrollit të strukturës mbas çlirimit të pykave rezultoi:

\_\_\_\_\_

7. Zgavrat, plasaritjet dhe hekurat e xhveshura u riparuan në përputhje me rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_.

8. Nga kontrolli i kuotave, akteve dhe përmasave të strukturës rezultoi se ato janë brënda largimeve të lejuara sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, me përjashtim të \_\_\_\_\_

Për të sjellë strukturën në kushtet e projektit janë kryer punimet e mëposhtme:

Në mbështetje të rezultateve të mësipërm, struktura merret në dorëzim dhe autorizohet vazhdimi i punimeve \_\_\_\_\_

Më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

**Drejtuesi teknik i punimeve**

**Drejtuesi teknik (ing. i objektit)**

**Mbikqyresi**

**AKT KONTROLLI**  
**NR \_\_\_\_\_**

1. Takimi: **Emri i subjektit të mbikqyrur** " \_\_\_\_\_ "
2. Vendodhja: \_\_\_\_\_
3. Data/ora: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_
4. Objektivat : **Progresi i punes** \_\_\_\_\_
5. **Pjesemarresit :**

Mbikqyresi \_\_\_\_\_

Drejtuesi teknik \_\_\_\_\_

Drejtuesi i punimeve \_\_\_\_\_

(te tjere)

**6. Konstatimet:**

Pershkrimi i situates	Zbatuar nga	Data e afatit te fundit
P.sh.Puna eshte ne hapat e saj te pare. <ul style="list-style-type: none"><li>• Kontraktuesi po punon per pastrimin e vendit te punes. Ne vendin e punes jane hedhur copera dhe materiale te ndryshme nga makinerite, te cilat do te ngarkohen dhe transportohen ne vendin e caktuar per depozitim.</li><li>• Instruktimi i punonjesve per sigurine ne objekt ne menyre qe te parandaloje demtimin e njerezve dhe te materialeve.</li><li>• Aparaturat e perdorura dhe siguria ne ndertese duhet te jene ne perputhje me ligjet shqiptare te sigurise ne vendin e punes.</li><li>• Azhurnimi me pikat e furnizimit me energji, uje etj</li><li>• Percaktimi i dates se takimit te ardhshem</li></ul>		





SIPËRMARRËSI: " \_\_\_\_\_ "

OBJEKTI: " \_\_\_\_\_ "

### **DEKLARATË TEKNIKE E SIPËRMARRËSIT**

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe pikës 15/d të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.3 datë 15/02/2001 "Për mbikqyrjen e punimeve dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar nënshkruesit e këtij dokumenti:

z. \_\_\_\_\_ drejtues ligjor i firmës me licensë nr. \_\_\_\_\_,

z. \_\_\_\_\_ drejtues teknik,

z. \_\_\_\_\_ përfaqësues i sipërmarrësit.

#### **Deklarojmë sa më poshtë:**

1. Objekti " \_\_\_\_\_ ", që ndodhet në qarkun e \_\_\_\_\_, në bashkinë/komunën e \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ është ndërtuar sipas projektit të zbatimit, kushteve teknike dhe standarteve në fuqi, dhe specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
2. Gjatë zbatimit të objektit janë respektuar kondicionet urbane të përcaktuara në lejen e sheshit të ndërtimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ dhe është kryer sistemimi i territorit sipas genplanit të miratuar.
3. Mbështetur në ecurinë e punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve, produkteve dhe punimeve të ndërtimit, dokumentacionin e hartuar nga sipërmarrësi për punimet e maskuara, projekti i miratuar në organet përkatëse nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ është zbatuar plotësisht, pa shtesa dhe pakësime dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit.
  - Objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është zbatuar sipas projektit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, investitori dhe organet përkatëse.
  - Vëllimet dhe klasat, sipas llojeve të punimeve në objekt (gërmime, beton, mure, etj) janë të njëjta me ato të specifikuara në kushtet e kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, investitori dhe organet përkatëse.
  - Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, investitori dhe organet përkatëse.
4. Strukturat bazë /mbajtëse (trupë i rrugës, skeleti mbajtës, muratuara mbajtëse, etj.) janë realizuar sipas kërkesave, materialeve e produkteve të parashikuara në projekt.
  - Disa prej tyre mund të jenë: i) \_\_\_\_\_, ii) \_\_\_\_\_, iii) \_\_\_\_\_, iv) \_\_\_\_\_, v) \_\_\_\_\_, vi) \_\_\_\_\_, vii) \_\_\_\_\_
  - Tulla/guri, janë furnizuar sipas standartit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Skeleti metalik sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Hekuri/betoni janë furnizuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Materiali mbushës / veshës i rrugës është sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Muratura mbajtëse është zbatuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Struktura b/arme monolite është realizuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Instalimet e furnizimit me ujë janë zbatuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Rrjeti i kanalizimit të ujrave të bardha/ të zeza është realizuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe ndriçimit janë zbatuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
  - Etj.

(Zgjidhen ato përcaktime që janë më të domosdoshme sipas llojit të objektit.)
5. Sistemi i infrastrukturës është provuar pa dhe me ngarkesë rezulton dhe rezulton i ndërtuar në përputhje me kërkesat e projektit dhe me rregullave teknike e standartet në fuqi.

6. Izolimi (termik, akustik, hidroizolues etj.) janë zbatuar sipas projektit, si dhe janë provuar dhe rezultojnë pa difekt.

Sipërmarrësi mban përgjegjësi për sa deklarohej më lart në rast se në objekt shfaqen difekte, gjatë kohës dhe kushteve të përcaktuara në aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, të cilat nuk janë si pasojë e administrimit dhe/apo shfrytëzimit, kur këto të fundit janë kryer brënda kushteve të parashikuara në projekt, në kontratën e sipërmarrjes dhe kushteve teknike në fuqi.

Kjo deklaratë hartohet në tre kopje, një kopje mbahet nga sipërmarrësi në arkivin teknik në dosjen e objektit, një kopje i dërgohet mbikqyrësit të punimeve dhe një kopje i dërgohet investitorit.

**Drejtuesi Teknik i Firmës**

**Drejtuesi Teknik i Objektit**

---

---

**Për Sipërmarrësin " \_\_\_\_\_ "**

**Drejtuesi Ligjor**

---

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 25.7.2011  
Doli nga shtypi më 25.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 22 lekë